

FEDERATA E SHENJËTARISË E KOSOVËS

MARRËVESHJA

MBI RIORGANIZIMIN E FEDERATËS SË SHENJËTARISË TË KOSOVËS

Prishtinë, 29.11.2006.

Në bazë të nenit 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2005 për regjistrimin dhe licencimin e Federatave dhe Shoqërive sportive të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nenit 2,1, 16.1.1, 20.1 dhe 25.1.6 të Statutit të FSHK-së dhe nenit 2 të rregullorës mbi organizimin e punës së Kuvendit të FSHK-së, Këshilli drejtues në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e Klubeve (anëtar) formues, në mbledhjen e mbajtur më 29.11.2006, aprovoi

MARRËVESHJEN

MBI RIORGANIZIMIN E FEDERATËS SË SHENJËTARISË TË KOSOVËS

Neni 1

Me këtë Marrëveshje Federata e Shenjëtarisë e Kosovës dhe Klubet e Shenjëtarisë sportive të regjistruara në Drejtoratet komunale për rini dhe sport, janë përcaktuar për riorganizimin e FSHK-së (në tekstin e mëtejme FSHK) sipas Ligjit mbi sportin dhe aktet nënligjore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, përkatësisht Departamentit të sportit të Kosovës, për realizimin e qëllimeve dhe të veprimtarisë nga neni 10 dhe 11 i Statutit të FSHK-së.

Neni 2

Selia e FSHK-së është në Shtëpinë e Sporteve, kati II, zyra nr.14, Rr. Agim Ramadani nr.43 në Prishtinë.

Neni 3

Me Marrëveshje, Klubet riorganizuese (në tekstin e mëtejme:anëtarët) janë përcaktuar që person i autorizuar i FSHK-së të jenë Kryetari i FSHK-së.

Neni 4

Anëtarët e FSHK-së janë marrë vesh në tërësi ti zbatojnë Aktet normative të FSHK-së, sipas të cilave është bërë edhe harmonizimi i akteve të anëtarëve nënshkruese të kësaj Marrëveshje.

Neni 5

Përfaqësimi i anëtarëve në Kuvendin e FSHK-së bëhet sipas nenit 2 të Rregullorës mbi organizimin e punës së Kuvendit të FSHK-së.

Neni 6

Anëtarët e FSHK-së obligohen që në tërësi ti realizojnë të drejtat dhe ti kryejnë obligimet që dalin nga neni 17 dhe 18 i Statutit të FSHK-së.

Neni 7

Anëtar me të drejta dhe obligime të barabarta mund të bëhen edhe Klubet e shenjëtarisë, të cilat në ndërkohë i plotësojnë kushtet sipas Rregullorës mbi formimin e Klubeve të shenjëtarisë dhe e nënshkruajnë këtë Marrëveshje.

Neni 8

Kjo Marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga anëtarët.

Neni 9

Anëtarët nënshkrues të Marrëveshjes së FSHK-së, janë.

1. KSH “BESIM MALA”
KRYETARI,
Hashim Mala

KRYETARI I FEDERATËS SË
SHENJËTARISË TË KOSOVËS,
Ali Pllana, ecc i dipl.

2. KSH “DARDANIA”
KRYETARI,
Shefket Ismali

3. KSH “DARDANI”
KRYETARI,
Islam Isufi

4. KSH “DRENICA”
KRYETARI,
Ilmi Jashari

5. KSH “IMER KRASNIQI”
KRYETARI,
Lulzim Krasniqi

6. KSH “HAJVALIA”
KRYETARI,
Bislim Musliu

7. KSH “SHABAN IBALLI”
KRYETARI,
Xhevxhet Lezi

8. KSH “SHENJESTRA”
KRYETARI,
Remzi Musliu

9. KSH “GJIMNAZISTI”
KRYETAR,
Nexhat Selaj

10.. KSH “ZENEL HAJDINI”
KRYETARI,
Hysni Fejzullahu

11. KSH “ZAHIR PAJAZITI”
KRYETARI,
Mursel Ahmeti